

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

- February 08 | Clean Call Alliance Meeting- OEGJK/KDWW
- February 13 | Workshop on the German Supply Chain Law - OEGJK/KDWW
- February 14 | Business After Hours & Publication of "Facts and Figures" for Kosovo -OEGJK/ KDWW and Konrad-Adenauer-Stiftung
- February 20 | E-WORLD ENERGY & WATER in Essen
- February 22 | Online-Seminar 10. Western Balkans Purchasing Initiative
- February 22 | Power to HR by KosovaJob
- February 23&24 | Digital Accounting Conference by Melita & Partners
- February 26 | N4CEB Workshop - OEGJK/KDWW

### Director's Note

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Menaxhmenti i OEGJK-së, bashkë me Kryetaren e Bordit, Eriola Bibolli dhe anëtarët e bordit Hana Qerimi dhe Drinor Selmanaj kanë qëndruar në një vizitë zyrtare në Berlin nga data 21 deri më 25 janar 2024.

Gjatë kësaj vizite delegacioni është takuar me:

- Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ekonomik / **Zyra e Kancellarit Scholz**
- Departamenti për EU-Enlargement, Evropë Juglindore, Turqi / **Ministria Federale për Ekonomi dhe Mbrojtje të Klimës**
- Shoqata Ombrellë e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë Gjermane / **DIHK**
- Komiteti Lindor i Ekonomisë Gjermane/ **Ost-Ausschuss der deutschen Wirtschaft**
- German Economic Team/ **Berlin Economics**
- Shoqata e diasporës **OASA e.V.**

Delegacioni ishte ftuar në pritjen e fillim-vitit nga Komiteti Lindor i Ekonomisë Gjermane, ku folës kryesor ishte **Ministri Federal i Financave, Christian Lindner**.

Gjatë pritjes anëtarët e delegacionit patën rastin të zhvillojnë takime me biznese gjermane, dhe me përfaqësues të institucioneve gjermane e ndërkombëtare.

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

The management of the German-Kosovar Business Association, with the Chairwoman of the Board, Eriola Bibolli, and KDWW-board members Hana Qerimi and Drinor Selmanaj, conducted an official visit to Berlin from January 21 to January 25, 2024.

During this visit, the delegation met with:

- The Department for International Economic Cooperation / **Office of Chancellor Scholz**
- The Department for EU Enlargement, South Eastern Europe, Turkey / **Federal Ministry for Economic Affairs and Climate Protection**
- The Umbrella Association of German Chambers of Commerce and Industry / **DIHK**
- The Eastern Committee of German Economy / **Ost-Ausschuss der deutschen Wirtschaft**
- German Economic Team / **Berlin Economics**
- The diaspora association **OASA e.V.**

The delegation was invited to the New Year's reception of the Eastern Committee of German Economy, where the keynote speaker was the **Federal Minister of Finance, Christian Lindner**.

During the reception, delegation members had the opportunity to hold meet with German businesses and representatives of German and international institutions.

Delegacioni i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare gjatë takimeve zyrtare informoi partnerët e saj rreth zhvillimeve të fundit ekonomike në vend, rolit të OEGJK-së si dhe rreth aktiviteteve në intensifikimin e marrëdhënieve dypalëshe.

U kërkua mbështetje nga Gjermania si aleat i Kosovës, veçanërisht për lobimin në favor të një Top Level Domain dhe një IP adrese të posaçme për Kosovën. Kosovës i duhet përkrahje në njohje digjitale, marrë parasysh jo vetëm identitetin digjital, por edhe për t'iu paraprirë sulmeve kibernetike, dhe për të rritur besueshmërinë e klientëve ndërkombëtar ndaj kompanive kosovare të sektorit Business Process Outsourcing (BPO). Sektor i cili ka shënuar rritje eksponenciale gjatë viteve të fundit.

Gjithashtu u adresua mundësia e Kosovës për t'u bërë anëtare e EU Single Digital Market.

Në të gjitha takimet u theksua rëndësia e bashkëpunimit rajonal, dhe viti jubilar i Procesit të Berlinit. OEGJK-së iu bë ftesë që të dorëzojë propozime konkrete me rekomandime për lehtësimin e tregtisë rajonale dhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal.

Institucionet partnere gjermane shfaqën interes për të përkrahur sërish Forumin Ekonomik Gjermano-Kosovar, i cili planifikohet të organizohet në tetor para Samitit të Ballkanit Perëndimor.

The delegation of the German-Kosovar Business Association informed their German partners about the role of KDWW, latest economic developments, and activities aimed at intensifying bilateral relations.

Support was sought from Germany as an ally of Kosovo, especially for lobbying in favor of a Top-Level Domain and a specific IP address for Kosovo. Kosovo needs support in digital recognition, considering not only digital identity but also to proactively safeguard against cyberattacks and enhance international client trust in Kosovar Business Process Outsourcing (BPO) companies—a sector that has experienced exponential growth in recent years.

Additionally, the possibility of Kosovo becoming a member of the EU Single Digital Market was addressed.

In all meetings, the importance of regional cooperation and the jubilee year of the Berlin Process were emphasized. KDWW was invited to submit proposals with recommendations for facilitating regional trade and strengthening regional cooperation.

German partner institutions expressed interest in supporting the German-Kosovar Economic Forum again, which is planned to be organized in October before the Western Balkans Summit.

**Fotografi nga vizita në Berlin**

**Impressions from KDWW's visit to Berlin**



**Përfaqësuesja e Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare, emërohet anëtare e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (KAAPARr) në kuadër të MASHTI**

**The representative of the German-Kosovar Business Association has been appointed member of the Council for Vocational and Adult Education and Training (KAAPARr) within the MESTI**

Muajin që po lëmë pas me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të datës 22.01.2024, Këshilltarja për Arsim Profesional në OEGJK, znj. Besarta Hyseni është emëruar

Through a decision of the Ministry of Education, Science, Technology, and Innovation (MESTI) dated January 22, 2024, Ms. Besarta Hyseni, the Advisor for Vocational Education at KDWV, has been appointed as

anëtare e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (KAAPARR) në kuadër të MASHT-it.

Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur është një organ këshillëdhënës i themeluar nga MASHT-it, i cili këshillon në çështje të përgjithshme të politikës arsimore, aftësimin profesional dhe arsimin të të rriturve në Kosovë.

Funksionet kryesore të KAAPRR përfshijnë rishikimin e çështjeve të zhvillimit të arsimit dhe aftësimin profesional, dhënien e këshillave, propozimeve dhe rekomandimeve për MASHT-in, duke përfshirë propozime për ligje dhe dokumente zyrtare lidhur me arsimin profesional. Këshilli gjithashtu siguron një forum gjithëpërfshirës për harmonizimin e politikave dhe qasjeve në tërë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional.

Gjithashtu këshillon dhe rekomandon profilet e programeve të arsimit dhe aftësimin profesional, duke përfshirë standardet për çdo profil, përmbajtjen profesionale të planprogramit për këto profile dhe kualifikimet profesionale që duhet të përfshihen brenda kornizës së kualifikimeve.

### **Laboratori "Dr. Limbach", një investim dhe storje suksesi nga Gjermania në Kosovë**

Rrjeti më i madh i laboratorëve mjekësor gjerman në Evropë, "Dr. Limbach", që numëron mbi 7000 punëtorë vetëm në Gjermani, ka zbankuar suksesshëm në Kosovë, duke nisur një epokë të re të diagnostikës në mjekësinë e Kosovës, por edhe rajonit. Investimi në këtë laborator, me një teknologji shumë moderne që ofron shërbime diagnostike të nivelit më të lartë profesional, kap vlerën mbi 1.3 milionë euro.

Sistemet e instaluar në Kosovë mbulojnë gjithë gamën e testeve biokimike, imunologjike, infektive, elektrolitet, parametrat tumoral dhe të tjera analiza. Këto sisteme drejtohen nga stafi i trajnuar në laboratorin qendror në Heidelberg. Por, mbi gjithë këtë proces është një kontroll i rreptë nga pranimi i pacientit, tek diametri i gjilpërës

a member of the Council for Vocational and Adult Education and Training.

The Council for Vocational and Adult Education and Training is an advisory body established by MESTI, which provides advice on general issues of education policy, professional development, and adult education in Kosovo.

The main functions of the Council include reviewing issues related to the development of education and vocational training, providing advice, proposals, and recommendations to MESTI, including proposals for laws and official documents related to vocational education. The Council also serves as an inclusive forum for harmonizing policies and approaches across the entire system of education and vocational training.

Furthermore, the Council advises and recommends the profiles of vocational education and training programs, including standards for each profile, the professional content of the curriculum for these profiles, and the professional qualifications that should be included within the qualifications framework.

### **Laboratory "Labor Dr. Limbach," a successful investment and story from Germany in Kosovo**

The largest network of German medical laboratories in Europe, "Dr. Limbach," with over 7,000 employees in Germany alone, has successfully entered Kosovo, initiating a new era of diagnostics in the healthcare sector of Kosovo and the region. The investment in this laboratory, equipped with highly modern technology offering diagnostic services at the highest professional level, amounts to over 1.3 million euros.

The installed systems in Kosovo cover the entire range of biochemical, immunological, infectious, electrolyte, tumoral parameters, and other analyses. These systems are operated by the trained staff at the central laboratory in Heidelberg. However, throughout this process, there is strict control from patient admission,

për të marrë gjakun e deri te mirëmbajtja dhe kontrolli i kualitetit.

Ky rrjet i laboratorëve ka nisur në vitin 1979, kur Dr. Med. Hans Jakob Limbach hapi laboratorin e parë në Heidelberg, ku edhe është qendra spitalore universitare më e specializuar në Gjermani.

Sikur çdo biznes kredibil gjerman, edhe laboratori Dr. Limbach është pjesë e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare.

through the needle diameter for blood collection, to maintenance and quality control.

This laboratory network began in 1979 when Dr. Med. Hans Jakob Limbach opened the first laboratory in Heidelberg, where the most specialized university hospital in Germany is also located.

Like any credible German business, the Dr. Limbach laboratory is also a part of the German-Kosovar Business Association.

### **Punëtori për Ligjin Gjerman për Zinxhirin e Furnizimit nga OEGJK**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) me anë të kësaj punëtorie, që do të udhëhiqet nga drejtoresha znj. Nora Hasani, ofron këshillim për kriteret dhe sistemet që duhet implementuar konkretisht mbrenda kompanisë që është furnitor për tregun gjerman.

Përmbajtja e punëtorisë do të jetë e koncentruar në atë se: Çfarë rregullon Ligji Gjerman i Zinxhirit të Furnizimit, Pasqyrën e detyrimeve kryesore për furnitorët, Udhëzime praktike për zbatimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit për të siguruar përputhjen me kërkesat ligjore dhe Integrimi i standardeve ESG në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit

Punëtorja mbahet në grupe të vogla (5-10 Persona) dhe regjistrimi bëhet vetëm nëpërmes [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org).

**Çmimi për anëtarët e OEGJK-së:** pa pagesë për një përfaqësues, 25 Euro për çdo përfaqësues shtesë.  
**Çmimi për jo-anëtarët:** 75 € për person, në çmim përfshihen materialet e punëtorisë dhe dreka.

### **Workshop on the German Supply Chain Law by the KDWW**

The German-Kosovar Business Association (KDWW), through this workshop led by the director, Mrs. Nora Hasani, offers advice on the criteria and systems that must be specifically implemented within a company that is a supplier to the German market.

The workshop's content will focus on: What the German Supply Chain Law regulates, the Overview of key obligations for suppliers, Practical guidelines for implementing monitoring and reporting mechanisms to ensure compliance with legal requirements, and the Integration of ESG standards in supply chain management.

The workshop is held in small groups (5-10 persons), and registration is only through [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org).

**The fee for KDWW members** is free for one representative, and 25 Euros for each additional representative.

**The fee for non-members** is 75 Euros per person, and it includes workshop materials and lunch.



## PODCAST PËR ZINXHIRIN E FURNIZIMIT

Germany Trade & Invest (GTAI), Agjencia për Promovimin Ekonomik të Republikës Federale të Gjermanisë, ka publikuar podcastin e fundit, ku flitet dhe për potencialin që ka Ballkani Perëndimor dhe Kosova, duke marrë shembull kompani anëtare të OEGJK-së.

Tema në këtë podcast është Zinxhiri i Furnizimit dhe Prokurimi, me fokus në Ballkanin Perëndimor, si zgjidhje për blerësit gjermanë që janë në kërkim të furnizuesve të rinj.

Ju ftojmë ta dëgjoni podcastin!

Spotify:  
<https://open.spotify.com/episode/Ofu5PgGrT53glhZxapwEoF?si=cK3ySEMhRtmL0ahhINqN7w>

## PODCAST ON SUPPLY CHAIN

Germany Trade & Invest (GTAI), the Agency for Economic Promotion of the Federal Republic of Germany, has released its latest podcast for the global market.

The discussion of this podcast was Supply Chain and Procurement Law, with a focus on the Western Balkans, including Kosovo.

We invite you to listen to the podcast!

Spotify:  
<https://open.spotify.com/episode/Ofu5PgGrT53glhZxapwEoF?si=cK3ySEMhRtmL0ahhINqN7w>

## E-WORLD ENERGY & WATER - Panairi kryesor i industrisë së energjisë në Evropë

Nga data 20 deri më 22 shkurt 2024, vendimmarrësit e industrisë së energjisë do të takohen në E-world Energy & Water në Essen të Gjermanisë.

## E-WORLD ENERGY & WATER - Europe's leading energy trade fair

From February 20 to 22, 2024, the decision-makers of the energy industry will meet at the E-world energy & water in Essen.

Nën moton "Zgjidhje për një të ardhme të qëndrueshme", ekspozuesit do t'u prezantojnë vizitorëve teknologji të qëndrueshme, shërbime inteligjente dhe qasje për arritjen e objektivave klimatike. Përveç kësaj, me Komunitetin E-world, ju keni mundësinë e një shkëmbimi gjatë gjithë vitit me industrinë.

Siguroni biletat tuaja tani për E-world energy & water, e cila do të mbahet nga data 20 - 22 Shkurt 2024 dhe përfitoni njohuri inovative për të ardhmen e industrisë.

Përfitoni nga mundësia për t'u takuar dhe shkëmbyer ide me ekspozues nga fusha të ndryshme të industrisë së energjisë. Përveç një programi të larmishëm në katër forumet e specializuara në sallat e ekspozitës, më 19 shkurt ju pret Takimi i Lideripit të Energjisë dhe më 20 Shkurt Forumi i Fibrave Optike. Dita e fundit e panairit prezanton Ditën e Karrierës me leksione interesante dhe sfida të reja mbi temën e karrierës në industrinë e energjisë.

Për më shumë informata vizitoni webfaqen: <https://www.e-world-essen.com/de/>

Under the motto „Solutions for a Sustainable Future“, national and international exhibitors will present to the trade visitors sustainable technologies, intelligent services, and approaches to achieving climate targets. In addition, with the E-world Community, you have the possibility of an all-year-round exchange with the industry.

Get your tickets now for E-world energy & water from February 20 to 22 and experience innovative insights into the future of the industry!

Take the opportunity to network and exchange ideas with exhibitors from diverse areas of the energy industry. In addition to an exciting program at the four expert forums in the exhibition halls, you can look forward to the Energy Leadership Meeting on February 19 and the Fiber Optics Forum on February 20. The last day of the trade fair presents the newly designed Career Day with interesting presentations and new challenges relating to careers in the energy industry.

For more information visit the website: <https://www.e-world-essen.com/de/>

### ATK aktivizon një shërbim të ri online

Administrata Tatimore e Kosovës ka publikuar versionin e ri të Sistemit Elektronik EDI, përmes të cilit do të kërkohet që të bëhet plotësimi dhe freskimi i informatave të tatimpaguesit.

Shërbimi i ri elektronik për plotësimin dhe freskimin e informatave të tatimpaguesit është funksionalizuar në Sistemin Elektronik EDI duke u ndërlidhur edhe me Sistemin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), përmes të cilit do të shfaqen drejtpërdrejtë informatat lidhur me adresën e personit (tatimpaguesit).

Përmes këtij shërbimi, tatimpaguesi është i obliguar për përditësimin e informatave të tij, me qëllim që Administrata Tatimore e Kosovës të ketë informatat e sakta për të komunikuar me tatimpaguesin.

Më konkretisht përmes shërbimit "Plotësimi dhe freskimi i informatave të tatimpaguesit", përveç informatave që merren nga regjistri i tatimpaguesve

### TAK has released the new online service

Tax Administration of Kosovo has released the new version of the EDI Electronic System, through which will be required the completion and update of taxpayers' information.

The EDI Electronic System now includes a new electronic service for completing and updating taxpayer information, which is connected to the Kosovo Cadastral Agency System (KCA), allowing information about the taxpayer's address to be displayed directly.

Through this service, the taxpayer is required to update his/her information so that the Tax Administration of Kosovo have the correct information and communicate with him/her.

More specifically, through the service "Completing and updating taxpayer information", in addition to the information obtained from the taxpayer register within

përmes Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe institucione tjera, tatimpaguesi do të jetë i obliguar që të ofroj/përditësoj edhe informatat shtesë, si:

- Adresën e tatimpaguesit, e cila duhet të jetë në përputhje me informatat e ofruara nga Sistemi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- E-mail i tatimpaguesit;
- Telefoni i tatimpaguesit;
- Mbajtësi i librave/kontabilistit;
- E-mail i mbajtësit të librave/kontabilistit;
- Llogaria bankare e tatimpaguesit, etj.

Për plotësimin e saktë të informatave të tatimpaguesit, ATK ka përgatitur “Udhëzuesin për plotësimin e informatave në profilin e tatimpaguesit”, të cilin do ta gjeni në dritaren përkatëse në të cilën bëhet plotësimi i të dhënave, andaj ju sugjerojmë që paraprakisht ta shfletoni udhëzuesin.

the Kosovo Business Registration Agency (KBRA) and other institutions, the taxpayer is required to provide/update additional information, such as:

- The taxpayer’s address, which must be in accordance with the information provided by the Kosovo Cadastral Agency System;
- The taxpayer’s e-mail;
- The taxpayer’s phone number;
- Bookkeeper/accountant;
- Bookkeeper/accountant e-mail;
- The taxpayer’s bank account, etc.

We advise you to peruse the “Manual for filling in the information in the taxpayer’s profile” beforehand to ensure accurate completion of the taxpayer’s information. This manual can be found in the corresponding window where the data is entered.

### **Konferenca e Doganës së Kosovës me komunitetin e biznesit**

Dogana e Kosovës ka mbajtur konferencën e saj me komunitetin e biznesit, ku mori pjesë përfaqësuesja e OEGJK-së, znj. Eriola Muhaxhiri.

Qëllimi i takimit këtij takimi janë shpalosja e arritjeve në krijimin e lehtësirave. Drejtori i përgjithshëm i Doganës, z. Agron Llugaliu prezantoi disa prej të arriturave të Doganës në krijimin e lehtësirave për tregtinë.

Ndër të tjera, ai theksoi se sa i përket eksportit të vitit të kaluar kemi pasur një rritje në sasi për 3% (prej 2022 në 2023), ndërsa në vlera vërehet që ka një rënie, por kjo rënie kryesisht i atribuohet rënies së vlerave të produkteve në eksport, si dhe për shkak se tregjet globale kanë qenë të ndryshueshme gjatë viteve që lamë pas.

Si lehtësira u përmendën: menaxhimi i riskut, avancimi i sistemeve si dhe llogaridhënies, procedimi i 95% të dërgesave në eksport për 0-30 minuta për dërgesë, ndërsa në import kjo kohë është mirëmbajtur për 65% të dërgesave.

### **Conference of the Customs of Kosovo with the business community**

The Customs of Kosovo held its conference with the business community, where the representative of the KD WV, Ms. Eriola Muhaxhiri, participated.

The purpose of this meeting is to present the achievements in facilitating trade. The Director-General of Customs, Mr. Agron Llugaliu, presented some of the achievements of Customs in facilitating trade.

Among other things, he emphasized that regarding the export of the previous year, there was an increase in quantity by 3% (from 2022 to 2023), while in values, there is a decrease, but this decrease is mainly attributed to the decrease in the values of products in exports, as well as due to the fluctuating global markets in the past years.

Facilitations mentioned include: risk management, advancement of systems and calculations, processing of 95% of export shipments within 0-30 minutes per shipment, while in import, this time is maintained for 65% of shipments.



Fillimi i zhdoganimeve në portin e Durrësit ka pasur një rritje në numrit e dërgesave përmes këtij porti për mbi 50%, çka ka rezultuar me:

- Kursim rreth 9 milion euro në baza vjetore
- Mundësi për kontrolle më të mira të përbashkëta me autoritetet e Shqipërisë
- Eliminim i procedurave të dyfishta fito dhe veterinare.

The start of customs clearance at the port of Durres has seen an increase in the number of shipments through this port by over 50%, resulting in:

- Savings of around 9 million euros on an annual basis
- Opportunities for better joint controls with the authorities of Albania
- Elimination of redundant phytosanitary and veterinary procedures.

Fotografi nga Konferenca e Doganës së Kosovës

Photo from the Conference of the Customs of Kosovo



YOUR CONTACT PERSONS AT KDWW

BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWW-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday – Friday | 8.30 – 16.30



**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa  
dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance  
and Membership

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



**Besarta Hyseni**

Udhëheqëse e  
Departamentit mbështetje  
dhe shërbime të anëtarëve  
Këshilltare për Arsim  
Profesional Dual

Head of Market Entry &  
Events  
Advisor for VET

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive

Përfaqësuese për Shërbimin  
e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant

Senior Expert Service  
Representative (SES)

[elena.elshani@oegjk.org](mailto:elena.elshani@oegjk.org)



**Eriola Muhaxhiri**

Këshilltare Ligjore

Legal Advisor

[eriola.muhaxhiri@oegjk.org](mailto:eriola.muhaxhiri@oegjk.org)